

Detyra e Mentorit Miqësia

Detyra e Mentorit Miqësia është e ndërtuar mbi një shembull ndërkombëtar. Kjo detyrë mbështetet nga (Velferðarsjóði barna) Fondi i Mbarëvajtjes së fëmijëve në Islandë. Ky fond filloi veprimtarinë e tij në vjeshtën e vitit 2001 në bashkëpunim me Shkollën e Lartë të Islandës, Shkollën e Lartë të Mësuesve të Islandës (Háskóla Íslands, Kennaraháskóla Íslands) dhe dy shkolla fillore në Reykjavík.

Thelbi i detyrës së mentorit Miqësia është që studentët e shkollës së lartë dhe nxënësit e shkollave të mesme t'u japin ndihmë dhe përkrahje nxënësve të shkollave fillore. Në këtë detyrë theksi vihet në përfitimin e dyanshëm që fëmijët dhe të rinjtë kanë duke u njohur dhe duke mësuar nga kushtet e njeri tjetrit.

Studentëve të shkollave të larta dhe nxënësve të shkollave të mesme u jepet mundësia të bëhen shembuj dhe forca pozitive në jetën e nxënësve të shkollave fillore dhe fëmijve të krijojnë lidhje me persona të pjekur dhe të rritur jashtë lidhjeve familjare.

Prindërit plotësojnë kërkesën për mentor(edukator) për fëmijët e vet në formularët që u dërgohen në shtëpi nga vetë fëmijët. Prindërit duhet të jenë parapërgatitur me mendimin që jo të gjithëve u jepet mundësia për mentor. Të gjithë pjesëmarrësit: fëmijë ose mentorë kalojnë nëpërmjet bashkëbisedave me kujdestarët e detyrës.

Bashkëpunimi midis fëmijës dhe mentorit zhvillohet me mirëkuptimin e prindërve. Roli i mentorit **nuk** është ai i mësuesit apo psikologut, por roli i atij që dëshiron të ngjallë besim, konfidencë dhe të bëhet shembull pozitiv për fëmijën. Koha e përbashkët e fëmijës dhe e mentorit nuk duhet të jetë e organizuar më përpara sepse e rëndësishme për ta është të qenit bashkë. Mundësitë për ta kaluar kohën bashkë janë të shumta si p.sh marshimet, vizitat në qendrat sportive, punët e dorës, lojrat, muzeumet, bashkëbisedimet, gatimet, koncertet, kinematë, pishinat, patinazhet, vizitat në Shtëpinë Ndërkulturore (Alþjóðahús) në bibliotekë ose kafene ku interesat e fëmijës diskutohen dhe lidhja midis tyre forcohet.

Të dhëna të hollësishme jepen në

www.vinatta.is